

STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

IUTEPAY SH.P.K.

DATE 14.11.2023

Neni 1 – Emërtimi i Shoqërisë

1.1 Sot me date 14.11.2023 u miratua ky Statut i shoqërisë lutePay shpk (ketej e tutje referuar si “**Shoqëria**”) nga Ortaku i Vetem lute Group AS, nje shoqëri e themeluar dhe qe ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin e Estonise, e regjistruar prane regjistrin tregtar Estonez me nr. 11551447, me seli ne Harju maakond, Tallinn, Rotermanni tn 19/1, 10145.

1.2 Kjo shoqëri me përgjegjësi te kufizuar eshte themeluar dhe organizuar ne përputhje me ligjet e Republikës se Shqipërisë.

1.3 Emri tregtar i shoqërisë do te jete: lutePay dhe / ose IUTE.

Neni 2 – Selia

2.1 Selia e Shoqërisë është në Rruga “Andon Zako Cajupi”, Ndertesa 3, hyrja 2, kati 3, Tiranë, Shqipëri.

2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të themelojë apo mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, në Shqipëri dhe/ose jashtë shtetit.

Neni 3 – Kohëzgjatja

3.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë të pakufizuar.

Neni 4 – Objekti

4.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do te jete kryerja e aktivitetit financiar te institucionit te parase elektronike ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe licencat e dhena nga autoritetet e caktuara me ligj. Objekti i Shoqërisë do te perfshije dhenien e shërbimeve këshilluese dhe shërbimeve te tjera ndihmese

BY-LAWS

OF THE LIMITED LIABILITY COMPANY

IUTEPAY SH.P.K.

DATED 14.11.2023

Article 1 - Company's Name

1.1 Today on 14.11.2023 has been approved this Bay-Law of the company lutePay SH.P.K. (hereinafter referred to as the “**Company**”) by the Sole Shareholder of lute Group AS, a company established and performing its activity in accordance with the laws of Estonia, registered with the Estonian commercial register with no. 11551447, having its legal seat at Harju maakond, Tallinn, Maakri 19/1, 10145.

1.2 This limited liability company is established and organized in accordance with the laws of the Republic of Albania.

1.3 The trade name of the Company will be: lutePay and / or IUTE.

Article 2 - Registered Office

2.1 The registered office of the Company is at Street “Andon Zako Cajupi” Building no.3, 2nd entrance, 3rd floor, Tirana, Albania.

2.2 The General Assembly may establish or close branches and/or representative offices, in Albania and/or abroad.

Article 3 - Duration

3.1 The duration of the Company is for an indefinite period.

Article 4 – Object

4.1 The object of the Company activity shall be the performance of the activity of an electronic payment institution pursuant to the applicable legislation and the licenses obtained by the competent authorities prescribed by law. The purpose of the Company shall include the rendering of counselling and other ancillary

per aktivitetin kryesor, sipas parashikimeve të ligjit. Shoqëria mund të ushtroje gjithashtu aktivitete të tjera financiare jo-bankare, në përputhje me licencat e dhëna nga autoritetet e caktuara me ligj. Kryerja e veprimtarisë si Agjent në Sigurime.

4.1 Shoqëria mund të ushtroje gjithashtu aktivitete të tjera financiare jo-bankare, në përputhje me licencat e dhëna nga autoritetet e caktuara me ligj.

4.2 Shoqëria mund të themeloje apo zoteroje pjesëmarrje në shoqëri të tjera tregtare, apo të bashkepuñoje, të lidhe marrëveshje *joint-venture* e marrëveshje të ngjashme, me shoqëri të tjera që kanë objekt të njejte, të ngjashëm apo të lidhur me objektin e Shoqërisë.

4.3 Shoqëria mund të kryejë transaksione financiare, transaksione me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të garantojë detyrimet e veta apo ato të palëve të treta duke vendosur mbi pasuritë e saj garanci të ndryshme sipas parashikimeve ligjore.

Neni 5 – Kapitali

5.1 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë ndahet mes ortakëve në një numër kuotash të barabartë me numrin e ortakëve. Secili ortak do të zotërojë një kuotë të vetme të kapitalit të Shoqërisë, e cila jep të drejta në raport me vlerën e kontributit të dhënë nga ortaku në kapitalin e Shoqërisë.

5.2 Kapitali aktual i Shoqërisë është 70,000,000 (shtatëdhjetë milion) Lekë, dhe përbëhet nga një kuotë e vetme, e shlyer dhe e zotëruar tërësisht nga ortaku i vetëm lute Group AS.

Neni 6 – Rritja e kapitalit

6.1 Asambleja e përgjithshme mund të rrisë pa kufi kapitalin e Shoqërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6.2 Në rastin kur rritet kapitali, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë rritjen në proporcion të kuotave të tyre në kapitalin e Shoqërisë. Të gjithë ortakët do të njoftojnë me shkrim Shoqërinë dhe ortakët e tjerë mbi vendimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e nënshkrimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga

services to the main activity, as prescribed by law. The company may also exercise other non-banking financial activities, in accordance with the licenses issued by the authorities designated by law. Carrying out activities as an Insurance Agent.

4.2 The Company may additionally perform other financial non-banking activities, pursuant to licenses obtained by the authorities prescribed by law.

4.3 The Company may establish or own participations in other companies, collaborate or enter into joint-ventures or other similar agreements, with other companies having the same, a similar or related purpose.

4.4 The Company may perform financial transactions related to movable or immovable properties, as well as to guarantee its own and third-party obligations, and provide guarantees over its properties pursuant to the law.

Article 5 – Share capital

5.1 The registered capital of the Company shall be divided between shareholders in a number of quotas equal to the number of company shareholders. Each shareholder shall own only one quota, which grants rights in proportion to the contribution given by the shareholder the Company's capital.

5.2 The current share capital of the Company is 70,000,000 (seventy million) Lekë, composed of one share, fully paid up and owned by the sole shareholder lute Group AS.

Article 6 – Increase of the Share Capital

6.1 The General Assembly may increase without any limit the Company's share capital, in accordance with the provisions of the law in force.

6.2 In case of increase of the share capital, all Shareholders have the right to subscribe to the increase in proportion to their quotas in the share capital of the Company. All Shareholders shall communicate in writing to the Company and to the other Shareholders on their decision whether to exercise or not their right of subscription within 30

data e vendimit për rritjen e kapitalit ose, në rast se këto nuk kanë qenë të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë që ka marrë këtë vendim, nga data e marrjes së njoftimit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme siç përcaktohet në paragrafin 6.1 Në rast se një ortak nuk kryen një komunikim të tillë brenda afatit të caktuar, ky konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e tij e nënshkrimit.

6.3 Në rastin kur disa ortakë heqin dorë nga e drejta e tyre për të nënshkruar pjesën që u takon, kapitali i panëshkruar mund të nënshkruhet nga ortakë të tjerë që kanë njoftuar mbi vendimin e tyre për të ushtruar të drejtën e nënshkrimit. Në këtë rast, këta ortakë mund të ri-ushtrjnë të drejtën për të nënshkruar kapitalin e panëshkruar në proporcion të kuotave të tyre përkatëse nëse ka më shumë se një ortak, ose për totalin e kapitalit të panëshkruar nëse ka vetëm një ortak.

6.4 Në rast se ortakët nuk e nënshkruajnë tërësisht rritjen e kapitalit, pjesa e panëshkruar e kapitalit mund të nënshkruhet nga persona të tretë.

Neni 7 – Zvogëlimi i kapitalit

7.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7.2 Ortakët marrin pjesë në zvogëlimin e kapitalit në përputhje me pjesët e tyre në kapitalin themeltar.

Neni 8 – Organet e Shoqërisë

Organet e Shoqërisë janë:

- 1) Asambleja e Përgjithshme; dhe
- 2) Administratori/ët.

Neni 9 – Asambleja e Përgjithshme

9.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme, e cila përbëhet nga të gjithë ortakët e Shoqërisë.

9.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë mendimin e tij dhe të votojë në

(thirty) days from the date of the resolution on the increase or from the receipt of the notice referred to in paragraph 6.1 above if they were not present at the General Assembly that resolved the increase. If a Shareholder fails to provide such communication within the prescribed term, his right of subscription is considered as waived.

6.3 In case some of the Shareholders waive their right to subscribe for their portion, the unsubscribed capital may be subscribed by other Shareholders who already communicated their decision to exercise the right of subscription. In this case, such Shareholders may re-exercise the right for the unsubscribed capital in proportion to their respective quotas if they are more than one or for the total unsubscribed capital if there is only one Shareholder.

6.4 In case the Shareholders do not wholly subscribe to the increased capital, the unsubscribed portion of share capital may be subscribed by third persons.

Article 7 – Decrease of the Share Capital

7.1 The General Assembly may decrease the Company's share capital in accordance with the provisions of the law.

7.2 The Shareholders participate in the decrease of the Company's share capital in proportion to their quotas in the capital.

Article 8 – Bodies of the Company

The bodies of the Company are:

- 1) the General Assembly; and
- 2) the Managing Director/s.

Article 9 - General Assembly

9.1 The decision-making body of the Company is the General Assembly which consists of all Shareholders of the Company.

9.2 Each Shareholder is entitled to attend the General Assembly Meeting, to express its opinion

përputhje me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tij..

9.3 Çdo ortak ka të drejtë të caktojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme një përfaqësues, jo domosdoshmërisht ortak, nëpërmjet një prokure me shkrim. Në çdo rast kjo prokurë mund të jepet për një mbledhje të vetme, e vlefshme për thirrjen e parë dhe të dytë.

9.4 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për të votuar nëpërmjet një pjese të kuotës që ky zotëron në rast se ky voton personalisht për pjesën tjetër.

9.5 Mbledhjet e Asamblesë së përgjithshme mund të mbahen edhe në një vend ndryshe nga selia e Shoqërisë, brenda Republikës së Shqipërisë ose jashtë shtetit.

9.6 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga Administratori/Administratorët sa herë që nevojitet për interesat e Shoqërisë ose nga legjislacioni në fuqi, ose nga ortaku/ortakët që zotërojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë. Në çdo rast, Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, jo më vonë se brenda muajit Qershor, për të diskutuar, shqyrtuar dhe miratuar pasqyrat financiare dhe bilancin vjetore të vitit ushtrimor paraardhës.

9.7 Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme duhet kryer me letër me postë të regjistruar ose postë elektronike që i dërgohet ortakeve tek vendbanimi i tyre ose në adresën e postes së tyre elektronike të paktën 7 (shtatë) ditë para ditës së caktuar për mbledhjen.

9.8 Njoftimi duhet të përmbajë çështje mbi të cilat do të diskutohet dhe do të merret vendimi, vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë, dhe informacionin mbi vendin dhe mënyrën e marrjes së dokumentacionit të mbledhjes si dhe elementë të tjerë që përcaktohen nga legjislacioni në fuqi.

9.9 Mbledhja e Asamblesë së përgjithshme do të quhet e thirrur dhe e mbledhur rregullisht dhe në rastin kur nuk përmbushen të gjitha formalitetet për thirrjen e saj, me kusht që, i gjithë kapitali i shoqërisë të jetë i pranishëm ose i përfaqësuar me prokurë sipas ligjit të

and to cast as many votes according to the shares owned by the Shareholder.

9.3 Each Shareholder is entitled to be represented by another person, not necessarily Shareholders, by a written proxy. In any case, the proxy may be given for one General Assembly Meeting only, valid for its first and second call.

9.4 The Shareholder may not issue a proxy to vote for a part of its participation when they are personally voting for the remaining quota.

9.5 The General Assembly Meeting may be held in a location other than the registered office, within the Republic of Albania or abroad.

9.6 The General Assembly Meeting is called by the Director/s as often as necessitated by the Company's interests or applicable law or by the Shareholders/s holding at least 5% (five per cent) of the share capital. In any case, the General Assembly Meeting shall be called at least once, within month of June of each year at the latest, for the purpose of discussing, examining and approving the annual statement of accounts of the previous financial year.

9.7 The call of General Assembly Meeting should be made through registered letter with advice of delivery or electronic mail sent to the Shareholders at the domicile of the Shareholders or electronic mail account of the Shareholders at least 7 (seven) days before the day set for the meeting.

9.8 The notice must contain the subjects to be discussed and to be resolved upon, the place, the time and the date of the first and second call, and information on the place and modalities to receive the documentation of the meeting and other elements as set forth by the applicable law.

9.9 The General Assembly Meeting shall be deemed validly convened and established even if all the formalities governing the calls are not observed, provided that the entire share capital is present or represented by proxy in accordance with the applicable law and all Shareholders

zbatueshëm dhe që të gjithë ortakët e pranishëm dhe të përfaqësuar në mbledhje të bien dakord për zhvillimin e saj pavarësisht nga mosrespektimi i formaliteteve të thirrjes së saj.

9.10 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet edhe kur pjesëmarrësit ndodhen në vende të ndryshme, dhe mund të zhvillohet gjithashtu nëpërmjet audio apo video-konferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të identifikohen nga kryetari i mbledhjes dhe ti jepet mundësia për të ndjekur dhe marrë pjesë aktivisht në diskutimet, dhe në të njëjtën kohë të votojnë mbi çështjet e rendit të ditës, si dhe të lexojnë dhe të marrin në dorëzim dokumente.

9.11 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme drejtohet nga kryetari i zgjedhur ndër ortakët e pranishëm apo të përfaqësuar në mbledhje. Në rast se nuk vlerësohet e nevojshme prania e një noteri, Asambleja e Përgjithshme zgjedh një sekretar i cili nuk është e nevojshme të jetë ortak.

9.12 Kryetari i mbledhjes ka fuqi të plota për të verifikuar prokurat dhe vlefshmërinë e tyre, të drejtën e ortakëve dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, dhe të vendosë nëse kjo e fundit është mbledhur rregullisht dhe në rast se është formuar kuorumi i duhur i ortakëve për të marrë vendime të vlefshme. Kryetari ka gjithashtu të drejtë të drejtojë diskutimet dhe të vendosë për mënyrën dhe procedurat e votimit.

9.13 Vendimet, procesverbali dhe lista e pjesëmarrësve të mbledhjes do të përgatiten menjëherë pas çdo mbledhjeje dhe do të firmosen nga kryetari dhe sekretari i mbledhjes dhe regjistrohen nga noteri në rast se kjo kërkohet.

Neni 10- Kuorumi dhe Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

10.1 Në rastin e vendimeve të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakë që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kuotave me të drejtë vote. Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk zhvillohet për shkak të mosformimit të kuoromit të duhur në thirrjen e parë, mbledhja do të mbahet me të njëjtin rend dite brenda jo më pak se 7 (shtatë)

present or represented in the meeting agree to proceed with the meeting regardless of irregularities of the calls.

9.10 The General Assembly Meeting may be held through the participation of the people in different places, and it may be conducted also via audio or videoconference, provided that all participants are identified by the chairman, are given the possibility to follow the discussion and actively participate in it, and in the simultaneous vote on the matters stated in the agenda, as well as to read and receive documents.

9.11 The General Assembly Meeting is chaired by the chairman appointed among the Shareholders present or represented at the meeting. Whenever the presence of a recording notary public is not required, the General Meeting appoints a secretary, who may not necessarily be a Shareholder.

9.12 The chairman of the meeting has full powers to verify the proxies and their power of attorney, the Shareholders' and their representatives' rights to attend the General Assembly Meeting and determine if the latter is regularly established and if a quorum of Shareholders is reached in order to adopt valid resolutions. The chairman is entitled also to chair the discussions and to set the methods and the procedures regarding the voting.

9.13 The resolutions, the minutes and the attending list of the meeting will be prepared promptly after each meeting and shall be signed by the chairman and the secretary of the meeting, and the recording notary public if required.

Article 10 – Quorum and Powers of the General Assembly

10.1 In case of ordinary resolutions, the General Assembly may only adopt valid resolutions if attended by Shareholders holding more than 30% (thirty per cent) of the voting quotas. If the General Assembly Meeting could not be held due to lack of the quorum in the first call, the meeting shall be reconvened with the same proposed agenda within and no later than 7 (seven) days from the first meeting. In case of

ditëve nga data e mbledhjes së parë. Në rastin e vendimeve të zakonshme, këto merren me votën pro të shumicës së ortakëve të pranishëm apo të përfaqësuar.

10.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë, ndërmjet të tjerash, mbi çështjet e mëposhtme:

(a) përcaktimin e politikave të biznesit;
(b) miratimin e Rregullores për Ushtrimin e Biznesit;
(c) Ndryshimi i Statutit;

(d) emërimin dhe shkarkimin e Administratorit/Administratorëve;
(e) emërimin dhe shkarkimin e ekspertit/ekspertëve kontabël të autorizuar dhe përcaktimin e masës së shpërblimit;
(f) Miratimin e pasqyrave Financiare të shoqërisë;
(g) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave nga ana e Administratorit
(h) Zvogelimi apo zmadhimi i kapitalit;

(i) themelimin apo formimin e një shoqërie të kontrolluar apo blerjen e kapitalit apo asetëve të tjera të ndonjë shoqërie tjetër;
(j) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procese të tjera kundrejt Administratorit/Administratorëve;
(k) çdo çështje tjetër të parashikuar nga ligji apo Statuti;
(l) menaxhimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, me përjashtim të rastit kur ligji ia njeht detyrimisht këto kompetenca administrimi administratorit të Shoqërisë.

10.3 Në rast të vendimeve të jashtëzakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë për qind) të kuotave me të drejtë vote. Në rast se Mbledhja e Asamblese e Përgjithshme nuk zhvillohet për shkak të mosformimit të quorumit të duhur në thirrjen e parë, mbledhja do të mbahet me të njëjtin rend dite brenda një muaji nga data e mbledhjes së parë. Në rastin e vendimeve të jashtëzakonshme këto merren me votën pro të jo më pak se ¾ (tre të katërtat) e ortakëve të pranishëm apo të përfaqësuar.

ordinary resolutions, the latter are adopted with the affirmative vote of the majority of the present or represented Shareholders.

10.2 The General Assembly may adopt, among others, ordinary resolutions on the following matters:

(a) setting the business policies;
(b) approval of the Regulations for Conduct of Business;

(c) Article of Associations amendments;
(d) appointment and removal of the managing director/s;
(e) appointment and removal of certified public accountant/s and determination of the respective remuneration;

(f) Financial Statements approval.

(g) Supervision of the business policies executions by the Administrator;

(h) Capital reduction or increase;
(i) to incorporate or form a new subsidiary undertaking or acquire any share capital or other securities of any corporate body;
(j) representation of the Company in court and in other proceedings against managing director/s;

(k) any other matter set out by law or its Articles of Association;
(l) ordinary and extraordinary management of the Company, unless the law mandatorily grants these administration powers to the managing director/s of the Company.

10.3 In case of extraordinary resolutions, the General Assembly may only adopt valid resolutions if attended by Shareholders holding more than 50% (fifty per cent) of the voting quotas. If the General Assembly Meeting could not be held due to lack of the quorum in the first call, the meeting shall be reconvened with the same proposed agenda within and no later than 7 (seven) days from the first meeting. In case of extraordinary resolutions, the latter are adopted with the affirmative vote of at least ¾ (three fourth) of the present or represented Shareholders.

10.4 Asambleja e Përgjithshme mund të marre vendime të jashtëzakonshme mbi çështjet e mëposhtme:

- (a) ndryshimin e Statutit të Shoqërisë;
- (b) miratimin e bilancit vjetor dhe shpërndarjen e fitimit vjetor;
- (c) ndarjen e kuotave;
- (d) emërimin dhe shkarkimin e likuidatorit/likuidatorëve dhe përcaktimin e masës së shpërblimit;
- (e) ristrukturimin, prishjen, shndërrimin, bashkimin, ndarjen, likuidimin e Shoqërisë apo riorganizimin e Shoqërisë në një formë tjetër;
- (f) çdo veprim që në mënyrë të arsyeshme pritet të japë si rezultat një rast likuidimi;
- (g) çdo çështje tjetër të parashikuar nga ligji apo nga ky Statut.

10.4 The General Assembly may adopt extraordinary resolutions on the following matters:

- (a) amendments in the By Laws of the Company;
- (b) adoption of the annual statement of accounts and distribution of annual profits;
- (c) division of quotas;
- (d) appointment and removal of liquidator/s and determination of the respective remuneration;
- (e) restructuring, dissolution, transformation, merger, amalgamation, demerge, winding up or liquidation of the Company or the reorganization of the Company into another corporate form;
- (f) taking of any action that is reasonably expected to result in a liquidity event;
- (g) any other matter set by law or these By Laws.

Neni 11- Emërimi dhe Shkarkimi i Administratorëve

11.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë, të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme, për një afat jo më të gjatë se 5 vite, me të drejtë ri-emërimi. Akti i emërimit të administratorëve do të përmbajë afatin e emërimit të tyre si dhe çdo kufizim të kompetencave të përfaqësimit në përputhje me parashikimet e ligjit.

11.2 Administratorët e Shoqërisë, secili prej tyre, apo të gjithë së bashku, mund të shkarkohen në çdo kohë me vendim të Asamblese e Përgjithshme.

Neni 12 – Administrimi dhe Përfaqësimi Ligjor

12.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme për një afat jo më të gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Akti i emërimit të administratorëve do të përmbajë aktin e emërimit të tyre si dhe çdo kufizim të kompetencave të përfaqësimit në përputhje me parashikimet e ligjit.

12.2 Administratorët kanë të drejtat, kompetencat dhe detyrën të kryejnë veprimet e parashikuara në ligj.

Article 11 – Appointment and Dismissal of the Managing Directors

11.1 The Company is managed by one or more managing directors appointed by the General Assembly for a term not exceeding 5 years, with the possibility of renewal. The act of the Managing Directors appointment shall provide the term of appointment, as well as any limitation to their legal representation powers in accordance with the law.

11.2 The managing directors may be dismissed, for all of them or each individually, at any time by resolution of the General Assembly.

Article 12 - Management and Legal Representation

12.1 The Company is managed by one or more managing directors appointed by the general meeting, for a term not exceeding 5 years, with the possibility of renewal. The act of appointment of the managing directors shall contain the term of office as well as any limitation to their legal representation powers in compliance with the law.

12.2 The managing directors shall have the rights, powers and duties to perform actions provided in the law.

12.3 Asambleja e Përgjithshme mund të përcaktojë dispozita të detajuara mbi detyrat e administratoreve, si dhe rregulla të brendshme procedurale për realizimin e administrimit të Shoqërisë, përfshirë konsultime me dhe/ose miratime paraprake nga përfaqësues të ortakeve, në lidhje me veprime të caktuara, dhe administratorët janë të detyruar të zbatojnë çdo rregull a procedure të tilla të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme.

12.3 The General Assembly may set forth detailed provisions on the duties of the managing directors, as well as internal procedure rules for the management of the company, including prior consultation with and/or approval by shareholder representatives, with respect to determined actions, and the managing directors shall comply with any such rule or procedure approved by the General Assembly.

Neni 13 – Eksperti/ët kontabël të Autorizuar

Auditimi i Shoqërisë, nëse kërkohet, do të kryhet nga një ose më shumë ekspertë kontabël që emërohen për një vit financiar nga Asambleja e Përgjithshme.

Article 13 – Certified Public Accountant/s

The internal auditing of the Company, if requested, is performed by one or more certified public accountants appointed from the General Assembly for one financial year.

Neni 14 – Viti Financiar

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbyllet më 31 Dhjetor të secilit vit.

Article 14 – Financial Year

The financial year starts on January 1st and ends on December 31st of each year.

Neni 15 - Fitimet

15.1 Fitimi që rezulton nga bilanci vjetor, pasi i zbriten të gjitha shumatat që Asambleja e Përgjithshme vendos të ndajë veçantë, i shpërndahet ortakëve në bazë të vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme në proporcion me kuotat e tyre.

15.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë, krijimin e rezervave të posaçme apo të jashtëzakonshme.

Article 15 – Profits

15.1 Profits resulting from the annual statement of accounts, after deducting all the sums the General Assembly decides to set aside, are distributed to the Shareholders upon resolution of the General Assembly in proportion to their quotas.

15.2 The General Assembly may resolve to create extraordinary or special reserves.

Neni 16 – Prishja – Ndarja – Bashkimi

16.1 Shoqëria priset në rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Në rast të prishjes me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, vendimi duhet marrë në përputhje me kuorumin e përcaktuar në nenin 10.3 më lart.

16.2 Shoqëria mund edhe të ndahet apo bashkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me kuorumin e përcaktuar në nenin 10.3 më lart.

Article 16 – Dissolution – Split-off – Merger

16.1 The Company is dissolved upon the occurrence of the events provided by the applicable law. In case of dissolution deliberated by the General Assembly, the resolution should be taken in compliance with quorum set forth under article 10.3 above.

16.2 The Company may also be split-off or merged upon resolution of the General Assembly in compliance with quorum set forth under article 10.3 above.

Neni 17 - Likuidimi

Article 17 – Liquidation

17.1 Në rast të prishjes, Shoqëria duhet të likuidohet.

17.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose disa likuidatorë, të cilët do të kenë të gjitha kompetencat dhe detyrat e përcaktuara nga ligji në fuqi.


17.3 Pas pagesës së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori/likuidatorët do t'ia shpërndajnë shumat që mbeten pas likuidimit, ortakëve, në proporcion me pjesët e kuotave të zotëruara prej tyre.

Neni 18 – Dispozitat Përfundimtare

Për çdo çështje të pa rregulluar shprehimisht nga Statuti do të zbatohet ligji Shqiptar në fuqi mbi Shoqërinë Tregtare.

**Ortaku i Vetëm
"IUTE GROUP AS"**

**Përfaqësuar nga Administratorit dhe Anëtari
i Bordit të Menaxhimit**



Z. Tarmo Sild

17.1 When dissolved, the Company must be liquidated.

17.2 To administrate this procedure, the General Assembly appoints one or more liquidators, who will have all the powers and duties provided by applicable law.


17.3 Following the payment of the creditors and collection of the outstanding credits, liquidator/s will distribute the remaining amounts to the Shareholders in proportion to their quotas.

Article 18 – Final provision

For any matter not specifically regulated by these Articles of Association, the Albanian Law on Trade Companies shall apply.

**Sole Partner
"IUTE GROUP AS"**

**Represented by Administrator and member of
the Management Board**



Mr. Tarmo Sild